



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2021 prot.

Tiranë, më 12.12 2022

VENDIM QARKULLUES

Nr. 57 datë 12.12 2022

**“PËR
SHITESA NË VENDIMIN E BA NR. 22 DATË 26.04.2022 “PËR
MIRATIMIN E TARIFAVE TË REGJISTRIMIT PËR KONKURS,
REGJISTRIMIT TË FITUESVE, PËR CIKLIN E PARË DHE TË DYTË, TË
TRETË TË STUDIMEVE DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR TË TRE
CIKLET E STUDIMEVE,
NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS “**

Në zbatim të pikës 3 /ç, neni 3, të pikës 30, të nenit 6, të nenit 49, të nenit 83, të nenit 85 të Ligjit nr.80/2015”Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH”, Statutin e UST, Rregulloren e UST, VKM nr. 780 dt. 26.12.2018 ”Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimeve në programet e ciklit të dytë të studimeve, në IAL Publike”, në Urdhërin të MAS nr. 544 datë 15.09.2022 ”Për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të dytë nga Master profesional në Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar” në Master i Shkencave në Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor, në Universitetin e Sporteve të Tiranës”, shkresa FSHL nr.1417/3 datë 19.11.2021 ”Për cjellje për miratim i dokumentacionit për riorganizimin e Programit të studimit të ciklit të dytë të studimeve nga master Profesional në Master shkencor në Mësuesinë Edukimin Fizik dhe Shëndetësor”, Vendimi i Senatit nr.130 datë 24.11.2021, Vendimi i Bordit të Administrimit nr. 52 datë 24.11.2021 ”Për miratimin paraprak për riorganizimin e programit të studimit nga Master Profesional në Master Shkencor, në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes” Vendimi i Rektoratit nr. 59 datë 02.12.2022 ”Për miratimin e propozimit të tarifës së shkollimit për programin e studimit Master i Shkencave në ”Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor” në UST, Vendimin e Senatit Akademik nr. 102 datë 09.12.2022, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I :

1. Të miratojë tarifën e shkollimit për programin e studimit ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor”, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, për vitin akademik 2022-2023, sipas tabelës bashkëngjitur .

2. Pikat e tjera të Vendimit e BA nr. 22 datë 26.04.2022 “Për miratimin e tarifave të regjistrimit për konkurs , regjistrimit të fituesve, për ciklin e parë dhe të dytë, të tretë të studimeve dhe tarifat e shkollimit për të tre ciklet e studimeve, në Universitetin e Sporteve të Tiranës “ nuk ndryshojnë.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi Administratori i Universitetit të Sporteve të Tiranës, FSHL, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore, Drejtoria e Marrëdhënive me Jashtë, Publikun dhe Studentëve.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në ëëë.ust.edu.al dhe tek portali transparenca universitare.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

P
Artur Cobani
Bri...



Tab. 1**FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES**

Emërtimi i Programit cikli i dytë Master Shkencor	Tarifa për kredit (në lekë)/ 120 kredite(në lekë) për vitin akademik 2022-2023
Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor (FSHL)	1750 (210000)